



BASHKIA SKRAPAR

PAKETA FISKALE - 2022

E NDRYSHUAR, ME VKB NR.31,DT.23.11.2023.





LËNDA

TAKSAT & TARIFAT VENDORE

1-TAKSAT-VENDORE

KUADRI LIGJOR DHE NËNLIGJOR.....	8
Ligjet bazë.....	8
VKM dhe Udhëzime	9-10
1- Taksat vendore.....	11
1.1- Taksa mbi ndërtesat.....	11
1.2-Taksa mbi Tokën bujqësore.....	16
1.3-Taksa mbi truallin.....	17
1.4-Taksa e fjetjes në hotel.....	18
1.5-Taksa e ndikimit në infrastrukturë	19
1.6-Taksa e Tabelës.....	20
1.7-Taksë e përkohshme për pronën pyll e kullotë.....	22
1.8-Taksa mbi të drejtën e kalimit të pronësisë për pasuritë e paluajtëshme.....	23
1.9-Të ardhura pjesore nga Taksa vjetore e mjeteve të përdorura.....	24
1.10- Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare.....	25
1.12-Tatim mbi të ardhurat personale.....	26

2-TARIFAT VENDORE.....2022

2.1-Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	27
2.2-Tarifa e ndriçimit.....	31
2.3-Tarifa e gjelbërimit.....	34
2.4-Tarifë për mirëmbajtjen e infrastrukturës.....	37
2.5-Tarifë për shfrytëzimin e infrastruktures nga B.madh.....	37
2.6-Tarifa për dru zjarri.....	39
2.7-Tarifa për përdorim Kullote për kullotje dhe kositje.....	40
2.8-Tarifë për zënien dhe përdorimin e hapësirave publike.....	40
2.9-Tarifë e Parkimit të automjeteve.....	41
2.10-Tarifë për linjat ajrore dhe nëntokësore.....	42
2.11-Tarifa për shërbimet administrative	43
2.12-Tarifa të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.....	43
2.13-Tarifa shërbimi nga institucionet e kulturës.....	44



2.14-Nivelet e tarifës për ujëtimin e tokave bujqësore.....	45
2.15-Tarifa për konvikthin , kopshtet, çrëdhjet	45
2.16- Tarifa për shërbime varrimi.....	46
2.17-Tarifë për dhënie të mjeteve të bashkisë për nevojat e qytetarëve.....	47
2.18- Tarifë për dhënie leje aktiviteti mbas orës 23.....	47
2.19 - Leje për ushtrim aktiviteti.....	48
2.20-Tarifat e liqensimit të veprimtarive të transportit.....	48
2.21-Tarifa e autorizimeve për qarkullimet në qytet të automjeteve të transportit për nevojat e veta.....	50
2.22- Tarifë për dhënie licensa për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.....	51
2.23-Tarifat e shërbimit që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi.....	51
2.24-Tarifat në sektorin e pyjeve dhe të kullotave tarifave bazë të lëndës drusore në këmbë.....	57
2.25-Tarifa për grumbullimin dhe nxjerrjen e prodhimeve të dyta.....	58
2.26-Tarifat dyshe me për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullor, publik për ushtrimin e veprimtarive.....	59
2.27-Tarifë për dhënie me qera të objekteve për banim ,tregëti e shërbime, për institucionet etj.....	63

3- AFATI I PAGESËS TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE.....65

4- KAMATË VONESË , GJOBA PËR KUNDRAVAJTJE ADMINISTRATIVE67

5- TË PËRGJITHSHME 70

TABELAT

Tab. TAKSAT VENDORE

Tab.A –Njësitë Administrative.....	6
Tabela Nr.1-Shkalla në përqindje të taksës , sipas kategorive të ndërtesave.....	13
Tabela Nr.2-Çmimi mesat. referues i shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllime banimi.....	14
Tabela Nr.3-Niveli i taksës mbi tokën bujqësore.....	16
Tabela Nr.4-Niveli i taksës mbi truallin.....	17
Tabela Nr.5-Niveli i taksës fjetjes në Hotel.....	18
Tabela Nr.6-Niveli i taksës mbi ndikimin në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.	19
Tabela Nr.7-Taksa e tabelës sipas llojit dhe sipërfaqes së Tabelës.....	21
Tabela Nr.8-Niveli i tarifës për Taksën e përkohshme për pronën pyll e kullotë.....	22
Tabela Nr.9-Niveli i taksës së kalimit të pronësisë mbi ndërtesat.....	24



2-TARIFAT VENDORE

Tabela Nr.10-Tarifa e Pastrimit dhe largimit të mbeturinave për familjarët.....	27
Tabela Nr.11-Tarifa e Pastrimit dhe largimit të mbeturinave për Institucionet.....	27
Tabela Nr.12-Tarifa e Pastrimit dhe largimit të mbeturinave për Biznesin.....	28
Tabela Nr.13-Tarifa e Ndriçimit për familjarët.....	31
Tabela Nr.14-Tarifa e Ndriçimit për Institucionet.....	31
Tabela Nr.15-Tarifa e Ndriçimit për Biznesin.....	31
Tabela Nr.16-Tarifa e gjelbërimit për familjarët.....	34
Tabela Nr.17-Tarifa e gjelbërimit për Institucionet.....	34
Tabela Nr.18-Tarifa e gjelbërimit për Biznesin.....	35
Tabela Nr.19-Niveli tarifës së mirëmbajtjes infrastrukturës.....	37...
Tabela Nr.20-Tarifa për shfrytëz. e infrastr. rrugore që mirëmbahet nga bashkia.....	38
Tabela 21-Tarifa për dru zjarri {Familjet dhe subj.bizn. në fshat }.....	39
Tabela Nr.22-Tarifa për përdorimin e kullotave për kullotje, e tjera.....	40
Tabela Nr.23-Niveli i tarifës së zënies së hapësirës publike	41
Tabela Nr.24-Tarifë e Parkimit të automjeteve.....	41
Tabela Nr.25-Nivelet e taksës për linjat ajrore dhe nëntokësore.....	42
Tabela Nr.26-Tarifa për shërbimet administrative.....	43
Tabela Nr.27-Tarifa të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.....	43
Tabela Nr.28-Tarifa shërbimi nga institucionet e kulturës.....	44
Tabela Nr.29-Nivelet e tarifës për ujitjen e tokave bujqësore.....	45
Tabela Nr.30-Tarifa për konviktin, kopshtet, Çerdhet.....	45
Tabela Nr.31-Tarifa për shërbime varrimi.....	46
Tabela Nr.32-Tarifë për dhënie të mjeteve të bashkisë për nevoja të qytetarëve.....	47
Tabela Nr.33 -Tarifë për dhënie lejë mbas orës 23.....	47
Tabela Nr.34- Lejë për ushtrim aktiviteti.....	48
Tabela Nr.35-Nivelet e tarifës për veprimtaritë e transportit.....	48
Tabela Nr.36-Tarifa e autorizimeve për qarkullim në qytet të automj. të transp. për nevojat e veta....	50
Tabela Nr.37-Tarifa për dhenie licensë për karburante dhe gazit të lëngshëm.....	51
Tabela Nr.38-Tarifat e shërbimit që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi.....	51
Tabela Nr.39-Për tarifën në sekt. e pyjeve dhe të kullotave tarifën bazë të lëndës drusore në këmbë...	57
Tabela Nr.40-Tarifa për grumbullimin dhe nxjerrjen e prodhimeve të dyta.....	58
Tabela Nr.41-Tarifat dysHEME për dhënie në përdorim, kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullor për ushtrimin e veprimtarive.....	59
Tabela Nr.42-Tarifë për dhënie me qera të objekteve për banim ,tregëti, institucione etj.....	64
Tabela Nr.43. Afati i pagesës së taksave dhe tarifave vendore	65
Tabela Nr.44-Niveli i kamatës vonesës.....	67
Tabela Nr.45-Niveli i gjobave për kundravajtjet administrative.....	67



A-Mbi bashkinë Skrapar

Bashkia Skrapar është rezultat i zbatimit të Ligjit Nr.115/2014, "Për ndarjen administrative-teritoriale në Republikën e Shqipërisë", nga bashkimi i ish Bashkisë Çorovodë, dhe ish Komunave Qendër, Bogovë, Vëndreshë, Çepan, Potom, Leshnje, Gjerrës dhe Zhepë, aktualisht Njësi Administrative.

Bashkia Skrapar, shtrihet brënda Qarkut Berat, në Shqipërinë jugore në pjesën Veri Lindore të krahinës Malore Jugore. Qendra e Bashkisë Skrapar është në Qytetin e Çorovodës, dhe ka në përbërje 9 njësi administrative, nga të cilat 8 në zonën rurale dhe mbulojnë 104 fshatra. Sipërfaqja gjithsej është 774 km²; tokë bujqësore 76 829 ha. pyje, shkurre dhe kullotë.

Popullsia, sipas regjistrit të gjëndjes civile (Dhjetor 2023), është 15 875 banorë, nr. Familjeve 6 814. Nga këto, banojnë në Qytet (Nj. Adm. Çorovodë) 5 330 banorë dhe nr. familjeve 2133. Në njësitë administrative banojnë 10 545 banorë dhe 4681 familje, 33.6 % banon në qytet dhe 66.4% në fshat. Numri i popullsisë është pakësuar në masë të konsiderueshme nga braktisja e zonave rurale. Disa nga arsyet janë: mungesa e infrastrukturës rrugore, arsimit, shërbimit shëndetësor etj. Vitet e fundit tendenca është drejt stabilizimit të këtij fenomeni.

Infrastruktura rrugore : Bashkia Skrapar lidhet me rrugë nacionale vetëm me Qytetin e Beratit, rrugë e amortizuar, dhe me rrugë rurale me qendrat Administrative. Gjëndja e tyre tepër e amortizuar, veç rrugës së Potomit dhe fshatit Therapel.

Mjedisi natyror karakterizohet nga një shumëllojshëri peisazhes me burime të pasura natyrore dhe ujore, kryesisht në gurin dekorativ, mermerin, inerte etj. Në teritorin e bashkisë ndodhen disa monumente natyrore, si Kanionet e Osumit, Ura e Kasabashit, Shpella e Pirogoshit, Parku Kombëtar I malit të Tomorrit etj, një destinacion i rëndësishëm turistik. Mbizotëron reliev malor e kodrinor. Lartësia mesatare 788 m. Zonat më të ngritura janë Tomorrica me majën më të lartë të Tomorrit 2 416 m, Kulmaku ka lartësinë 2 173 m, dhe zona e Potomit. Vëndet e ulta shtrihen në Luginën e Osumit, Çorovodës, dhe Tomorricës. Klima mesdhetare malore. *Temperatura mesatare vjetore shumëvjeçare 12.9 gradë, mesatarja e muajve më të ftohtë 6.4 gradë dhe më të ngrohtë 23 gradë. Tokat bujqësore janë kryesisht të kafenjta malore 52 %, të hirta kafe etj.*

Sfidat kryesore të së ardhmes janë përmirësimi i infrastrukturës rrugore, arsimore dhe shëndetësore, zhvillim i bujqësisë, vreshtarisë, pemtarisë dhe blektorisë, mbrojtja e mjedisit nëpërmjet miradministrimit të burimeve natyrore, pyllëzimit dhe marrjen e masave ndaj erozionit të tokës bujqësore dhe pyjore, zhvillimi i agrobiznesit, turizmit, sidomos turizmit të raftingut, familjar dhe të aventurës. Rritja e kapaciteteve në hoteleri, në njësitë e shërbimit bar-kafe, Sistorante, përmirësimi i cilësisë së shërbimit, është një sfidë më vehte që kërkon stimulim dhe mbështetje të biznesit.

Klasifikimi i fshatrave të njësive administrative sipas kategorisë së tokës jepet në tabelën a



Tabela a- Njësitë Administrative, { Lagjet, fshatrat në teritorin e tyre. Kategoria e Tokës Bujqësore . }

Nr	Njësia Administrative	Nr. fshatrave						
			Emri	Kat. Tokës	Emri Fshatit	Kat. Tokës	Emri Fshatit	Kat. Tokës
I	COROVODË	Lagje	L.Çlirimi	IV				
			L.H.Seitaj	IV				
			L.E.Caka	IV				
			L.2 Dhjetori	IV				
			L.5 Shtatori	IV				
II	QENDËR	23	Mollas	V	Reovicë	VI	Slatinjë	V
			Gradec	VI	Zogas	VI	Cerovë	VI
			Koritë	VII	Osojë	VI	Nishicë	VI
			Radësh	V	Veleshnje	VI	Vërzhezhë	V
			Liqedh	V	Dhores	V	Storë	V
			Munushtir	V	Kalanjas	V	Buzuq	V
			Sharovë	III	Polenë	VI	Çerenisht	V
			Grepckë	V	Veleshnje	VI		
III	BOGOVË	8	Bargullas	V	Përparim	VI		
			Novaj	VI	Dobrushë	VII		
			Jaupas	II	Selan	V		
			Nishovë	V	Kakrukë	IV		
IV	VËNDRESHË	8	Spatharë	VII	Vëndreshë III	VII		
			Ibrollarë	V	Vala	V		
			Vëndreshë I	V	Lavdari	V		
			Vëndreshë II	V	Therepeli	V		
V	ÇEPAN	14	Çepan	V	Zabërzan I ri	V	Kakos	VI
			Zabërzan	V	S. I Madh	V	Muzhëncë	V
			Rog	V	S. I Vogël	V	Prishtë	V
			Muzhakë	V	Strenec	V	Malind	V
			Blezëncë	V	Qeshibes	VI		
VI	POTOM	14	Gërmenj	VI	Nikollarë	VII	Gjeorgjovë	VI
			Qafë	VI	Backë	VII	Potom	VI
			Koprëncë	VI	Melckë	VII	Visockë	VII
			Staraveckë	VI				



VII	LESHNJE	8	Leshnje	V	Vlushë	V	Turbëhovë	VI
			Krushovë	VII	Gostenckë	V	Krastë	VII
			Faqekuq	VII	Kapinovë	VII		
VII I	GJERBËS	13	Mëlovë	VI	Vishanj	VI	Rehovë	V
			Zaloshnje	VI	Barç-Mal	V	Kuç	VI
			Gjerbës	V	Barç	VII	Grëms	VI
			Ujanik	VII	Floq	VI	Gjogovicë	VII
			Gradec	V	Strafickë	V		
IX	ZHEPË	16	Tërrovë	V	Dobrenj	V	Çerricë	VI
			Rromas	VII	Burranj	V	Leskovë	V
			Dunckë	VII	Çorotat	VI	Grevë	VII
			Trebël	V	Gurrazes	VI	Kovaçanj	VII
			Luadh	VII	Zhepë	VI	Postenë	VII
			Shpatanj	VI				
9	SHUMA	104	Fshatra					



KUADRI LIGJOR DHE NËN LIGJOR.

LIGJET BAZË

Ligji nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” është ligji bazë që përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore në drejtim të mbledhjes, administrimit dhe krijimit të taksave dhe tarifave të reja.

Më poshtë jepet legjislacioni mbi të cilin është mbështetur hartimi i paketës fiskale.

- ❖ Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar,.
- ❖ Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar.
- ❖ Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “ Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.
- ❖ Ligji nr. 68/2017, “Për financat e qeverisë Vendore”.
- ❖ Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet Administrative”
- ❖ Ligji nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë vendore, i ndryshuar me ligjin nr.9661, datë 12.06.2006 dhe ligjin nr.9797, datë 23.07.2007
- ❖ Ligji nr.10473, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar.
- ❖ Ligji nr.9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- ❖ Ligji nr.9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar.
- ❖ Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.
- ❖ Ligji nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit”, i ndryshuar.
- ❖ Ligji nr.10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin minerar në Rep.Shqipërisë”, i ndryshuar.
- ❖ Ligji nr.107/2014, “Për Planifikimin dhe zhvillimin e teritorit”
- ❖ Ligji nr.9482, dt.03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” , i ndryshuar.
- ❖ Ligji nr.10081, datë 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në R.Shqipërisë”, i ndryshuar.
- ❖ Ligji nr.10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në R.Shqipërisë.”
- ❖ Ligji nr.8450, datë 24.02.1999, Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar .
- ❖ Ligji nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar.
- ❖ Ligji nr.9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin kullosor”, i ndryshuar.
- ❖ Ligji nr.8308, datë 18.3.1998, “Pë transportet rrugore”



VENDIME DHE UDHËZIME

- VKM nr.457, dt.26.7.2023, “Për disa ndryshime në VKM nr.132,datë 07.03.2018, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ”Ndërtesa”, e bazës së taksës, për kategori specifike,natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.”.
- VKM nr.132,dt.7.3.2018, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ”Ndërtesa”, e bazës së taksës, për kategori specifike,natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.”, të ndryshuar.
- Udhëzimi i M.Financave nr.1,dt.12.01.2007,”Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari tregtare apo shërbimi,ambulantë si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor.
- Udhëzim i përbashkët(Ministri i Financave -Ekonomisë dhe Ministri Brendshëm), nr.17, dt.20.6.2022, “Për përcaktimin e uniformitetit minimal, të standarteve proceduriale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”.
- Udhëzimi i përbashkët (Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë) nr.655/1, datë 06.02.2007 “Për përcatimin e uniformitetit të standarteve proceduriale dhe të raportimit të Sistemit të Taksës Vendore”.
- VKM nr.511,dt.27.7.2022, “Për një ndryshim në VKM nr.666, dt.10.10.2019,” në lidhje me ndryshimin e tarifës ushqimore për konviktorët”
- VKM nr.575,datë “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”,
- Udhëzim i ministrit të financave nr.26,datë04.09.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar.
- VKM nr.7,datë 04.01.2012,“Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare”, i ndryshuar.
- VKM nr.970,datë 02.12.2015,“Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçensave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar me VKM nr.344, dt.19.4.2017,
- VKM nr.273,dt.16.5.2018, “Pwr krijimin e regjistrit qendrortw bazws tw tw dhwnave pwr llogaritjen e taksws vendore tw pasurisw sw paluajtshme “Nwrtesw” (Kadastra Fiskale)
- VKM nr.559, datw 29.7.2022, “Pwr pwrcaaktimin e çmimeve dhe tarifave pwr dhwnien nw shfrytwzim/pwrdorim tw fonditpyjor kombwtar,pwr veprimtari ekonomike, si dhe pwr prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”.
- VKM nr.632, datë 11.06.2009 “Për tarifatat në sektorin e kullotave”
- VKM nr.54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve të dhënies me qira ,enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.



-
- VKM nr.992, datë 09.12.2015, “Për disa ndryshime në VKM-në nr.54 , datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve të dhënies me qira ,enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”
 - VKM nr.1108, datë 30.12.2015, “Për transferimin, nga Ministria e bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të ujërave, të Bashkitë,të ifrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit.
 - Udhëzimit nr.541/1 të Ministrit për Çeshtjet Vendore,Udhëzues për zbatimin e VKM-së nr.1108, date 30.12.2015, Për transferimin, nga Ministria e bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të ujërave, të Bashkitë,të ifrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit.
 - Udhëzimi nr.6756, datë 03.09.2015, i Ministrit të Zhvillimit Ekonomik,Turizmit,Tregtisë dhe sipërmarrjes “Për përcaktimin e kriterëve të dhënies me qira ,enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”
 - VKM nr.469, datë 03.06.2015, “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencës të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore.”
 - VKM nr.992, datë 09.12.2015, “Për disa ndryshime në VKM-në nr.54 ,datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve të dhënies me qira ,enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.
 - Udhëzimi nr.30,datë 27.12.2011,“Për menaxhimin e Aktiveve në njësitë e Sektorit Publik”.
 - Udhëzimi nr.15,datë 24.07.2007, “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçensave, çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në sektorin e transportit” ,i ndryshuar.
 - Udhëzimi nr.5627, dt.18.11.2016, “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”
 - VKM nr.711, dt.29.10.2014, “Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në teritorin e Republikës Shqipërisë”.
 - VKM Nr.607, datë 29.07.2020, “Tarifat për llojet e Shërbimeve që ofrohen nga Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi”



TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE

1-TAKSAT VENDORE

TAKSA MBI PASURITË E PALUAJTSHME

Pagesës së taksës mbi pasuritë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë apo juridikë, vëndas ose të huaj pronarë ose përdorues së pasurisë, ndërtesë, tokë bujqësore, truall, bëjnë përjashtim kur me ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasuritë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë, për pasuritë që nuk janë pajisur me dokument. Zyra e taksave dhe tarifave vendore njeh si dokument ligjor, dokumentat e mëposhtme:

- a- Vërtetimin e pronësisë të lëshuar nga ZRRPP.
- b- Vendimin e komisionit të kthimit të pronave.
- c- Vendimin e Privatizimit
- d- Vetëdeklarimin.
- e- Vendimet e komisionit të verifikimit të pasurisë të paluajtshme.

“Pasuri e paluajtshme janë: Trualli, Toka bujqësore dhe ndërtesat mbi dhe nën tokë sipas përcaktimit të Kodit Civil dhe legjislacionit për rregjistrimin e pasurive të paluajtshme.

1.1 -TAKSA MBI NDËRTESAT.

1.1.1- Përkufizime.

- a- Ndërtesë”, objekti/objektet e ndërtuara mbi/nën sipërfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe që përfaqëson një strukturë ndërtimore me një ose më shumë njësi pronësore, e cila është objekt i taksës mbi ndërtesën sipas përcaktimit të dhënë në ligj.
- b- “Ndërtesë e papërfunduar”, objekti ndërtimor në tërësi ose/edhe ajo pjesë e ndërtesës ekzistuese, për të cilin zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi, por që nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi



- c- “Përdorues”, individ, personi fizik ose personi juridik, që ka në përdorim ndërtesën/ njësinë pronësore për qëllime banimi, veprimtarie ekonomike apo për veprimtari joekonomike, pavarësisht nga fakti nëse kjo ndërtesë/njësi pronësore ka titull pronësie ose jo.

1.1.2- Taksapaguesit e Taksës mbi ndërtesat

- a- Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vëndas apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Bashkisë Skrapar, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur me ligj përcaktohen ndryshe.
- b- Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.
- c- Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejës përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

1.1.3-Baza e taksës .

- a- Vlera aktuale e pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore e njohur me dokumenta ligjorë ose vlera e përcaktuar me një nga metodat e përshkruara në VKM Nr.132, datë 07.03.2018, I ndryshuar, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “Ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit”. **Vlera e pasurisë është baza e taksueshme** mbi të cilën aplikohet shkalla e taksës së pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore.
- b- Vlera e pasurisë llogaritet si shumëzim i çmimit për metër katror me sipërfaqen e ndërtesës/njesisë pronësore.

1.1.4- Përcaktimi i çmimit vlerësues dhe i sipërfaqes së ndërtesës/njesisë pronësore .

Përcaktimi i vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore bazohet mbi prioritetet e vlerësimit, duke ndjekur një radhë të caktuar. Baza e vlerësimit mbështetet te vetëdeklarimi, si një detyrim për çdo taksapagues, për të vijuar më tej edhe me metodat alternative, nëse vetëdeklarimi nuk bëhet, nuk është i saktë apo nuk disponohen të dhëna të plota për një vlerësim të drejtë të pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore, që duhet të taksohet.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për efekt të përcaktimit të bazës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesë, ndjekin këtë radhë vlerësimi.

- a- Vetëdeklarimi
- b- Përcaktimi i çmimit të vlerësuar dhe i sipërfaqes së ndërtesës, bazuar në regjistrin e pasurive të paluajtshme të mbajtur nga zyrat vendore (ZVRPP)
- c- Përcaktimi i çmimit të vlerësuar sipas çmimeve mesatare të shitblerjes së ndërtesave/ njësive pronësore .
- d- Kur vlerësimi sipas pikave a, dhe b, më lart është i pamundur, çmimi i vlerësuar për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore do të korrespondojë me çmimin mesatar referues të ndërtesave që përdoren për qëllime banimi .



NË ZBATIM TË KËSAJ PIKE/PËR BASHKINË SKRAPAR

1.1.5-Për efekt të llogaritjes të taksës mbi ndërtesën/njësi pronësie Bashkia Skrapar ndahet në tre Zona:

- A. Zona 1 – Qyteti Çorovodë
- B. Zona 2- Njësia Administrative Qendër
- C. Zona 3-Njësitë administrative:Bogovë, Vëndreshë, Çepan,Potom, Leshnje,Gjerbës, Zhepë.

1.1.6- Shkalla e taksës. Për efekt të llogaritjes së taksës për ndërtesën/njësi pronësore, shkalla në përqindje të taksës , sipas kategorive të ndërtesave, është si më poshtë: (Tabela Nr.1)

Tabela Nr.1-Shkalla në përqindje e taksës, sipas kategorive të ndërtesave:

N r	Kategoritë e ndërtesës/ njësi pronësore		ZONA		
			1-Qyteti Çorovodë	2-Njësia Administrative Qendër	3-Njësitë e tjera të Bashkisë
1	Për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për banim	Shkalla e taksës	0.05 % (100%)	0.04 %(-20%)	0.035 %(-35 %)
2	Për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike	Shkalla e taksës	0.24%(+20%)	0.18 %(-10%)	0.14 %(-30%)
3	Për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë, sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi	Shkalla e taksës	Baza e taksës së ndërtesës llogaritet në masën 30(tridhjetë)për qind të shkallës së taksës të përcaktuar me ligj, shumëzuar me koston e ndërtimit të parashikuar në lejen e miratuar të ndërtimit.		

1.1.7- Çmimi i vlersuar për vlersimin e pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore për qëllime banimi. (Tabela nr.2)

**Tabela Nr.2-Çmimi mesatar referues i shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllime banimi.**

Nr	Kategoritë e ndërtesës/ njësi pronësore	ZONA		
		1-Qyteti Çorovodë	2-Njësia Administrative Qendër	3-Njësiti e tjera të Bashkisë
1	Për ndërtesën/njësine pronësore që përdoret, shfrytëzohet për banim, pavarësisht nga viti ndërtimit. {Para apo Pas vitit 1993}	25 000 lek/m²(100%)	20 000 lek/m²(-20%)	16 250 lek/m² (-35 %)

1.1.8-ÇMIMET MESATARE PËR METËR KATROR SIPËRFAQE NDËRTIMI PËR NDËRTESAT QË NUK SHËRBEJNË PËR BANIM

a) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) here më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori përfshihen edhe njësiti tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhimi, tregtimi apo shërbimi me pakicë

b) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

c) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ambiente parkim i hapur, pishinë e hapur, ambiente sportive të hapura, të tilla si: fusha futbollit, minifutbollit, basketbollit, volejbollit, tenisi, golfi, pista për gara të ndryshme sportive të atletikës, motorike, garave me kuaj e të tjera të ngjashme me to; porte dhe aeroporte të çdo kategorie, për të gjithë sipërfaqen e shtrirë që ato zënë, është 30 (tridhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

ç) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, të tilla si: prodhim, përpunim apo magazinim të lëndëve të para, të gjysmëprodukteve apo të produkteve të gatshme industriale, si: fabrika, magazina, depo, silos, magazina frigoriferike të produkteve ushqimore (përfshijë ato të njësive të tregtimit dhe të shërbimit), si dhe objektet e tjera të ngjashme me to, është 50 (pesëdhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, sipas qyteteve.

Në këtë kategori përfshihen dhe ndërtesat që shërbejnë për veprimtari arsimore jopublike të çdo niveli, si dhe ambientet sportive të mbyllura, përfshirë dhe pishinat e mbyllura.

d) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si: grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale, është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor.

dh) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimore për ndërtimet e reja regjistruar sipas lejes së përdorimit në ASHK, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të indeksitet me koeficientin 0.2 (zero pikë



dy) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqes së apartamentit të banimit sipas listës së përcaktuar aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, për 5 vitet e para pas regjistrimit të lejes së përdorimit në ASHK.

1.1.9-. Vlera e pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”, referuar verifikimeve në terren.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, kryejnë korrektime në regjistrin e bazës së të dhënave. Korrektime kryhen bazuar në verifikimet periodike në terren për sipërfaqen e ndërtesës/ njësisë pronësore. Verifikimi në terren shërben edhe për të regjistruar për herë të parë ndërtesa/njësi pronësore ose nënndarje të saj. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas procedurave të përcaktuara në këtë metodologji, në çdo rast, pasi bëjnë vlerësimin e vlerës së pasurisë së paluajtshme, hedhin të dhënat në regjistrin e bazës së të dhënave, për efekt të përcaktimit të bazës së taksës dhe llogaritjes së shumës së taksës për t’u paguar nga taksapaguesi.

1.1.10- Sipërfaqja e prezumuar

Nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njësisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijnë:

- a) 100 (njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim;
 - b) 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të ndryshuar.
- Për ndërtesat e tjera, të cilat nuk shërbejnë për qëllime banimi, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë verifikimin në terren, për të përcaktuar sipërfaqen dhe për të llogaritur bazën e taksës.
- Kur gjatë verifikimeve në terren konstatohen dëmtime të ndërtesave për shkaqe të fatkeqësive natyrore (tërmet/zjarr/përmytje etj.), të cilat ndryshojnë vlerën e kësaj pasurie, njësia e vetëqeverisjes vendore, sipas rastit që i paraqitet, ngre një komision, i cili vlerëson dhe korrekton vlerën e ndërtesës. Vlerësimi bëhet sipas gjendjes fizike në të cilën paraqitet ndërtesa e dëmtuar.

1.1.11- Përfshihen nga taksa mbi ndërtesat:

- a) pronat e shtetit dhe të njësisë të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- e) strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”;
- ë) ndërtesat e banimit të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie ose pension social, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët, ose dhe me persona në ngarkim të tyre që janë të paaftë për punë;
- f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;



g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jo fitimprurëse.

1.1.12-Baza ligjore: Ligji nr.9632, dt. 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore “, i ndryshuar, Neni 22- 22/5.VKM nr.132, datë 07.03.2018, i ndryshuar, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtëshme “ Ndërtesë”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit”.

1.1.13- Afati pagesës. Afati i pagesës sipas kategorive është sipas përcaktimeve në pjesën 3 “Afati pagesës të Taksave dhe tarifave vendore” ,të kësaj pakete.

1.1.14- Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesat. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesat bashkë me nënkategorizimet është Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Skrapar si dhe inspektorët e taksave pranë Njësive Administrative.

1.2-TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

1.2.1-Baza e taksës. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore në ha në pronësi ose përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi, përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë atë: certifikatë pronësie, **akt i marrjes në pronësi ose përdorim përfituar nga ligji 7501, vendim të komisionit të kthimit të pronave e çdo document tjetër ligjor që vërteton pronësinë mbi tokën.** Në mungesë të dokumentave të mësipërme , përdoruesi bën një deklaratë të sipërfaqes së tokës bujqësore pranë bashkisë ose njësisë administrative .

1.2.2- Llogaritja e taksës. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme (sipërfaqja e tokës)

1.2.3- Niveli taksës . Niveli i taksës është sipas tabelës Nr.3

Tabela Nr.3-Niveli i taksës mbi tokën bujqësore.

Klasifikimi sipas kategorisë të tokës bujqësore	Niveli i taksës në lekë/ha
I	2 800
II	2 100
II	1 400
IV	1 350
V	1 250
VI	1 200
VII-X	1 100



1.2.4-Baza Ligjore për klasifikimin i kategorisë së tokës bujqësore: Ligji nr.8752, datë 26.03.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave të ZMT në komuna/bashki dhe seksioni i AMT në Qark” dhe VKM Nr.532, datë 31.10.2002, “Për ushtrimin e funksioneve dhe detyrimet e këtyre strukturave të AMT” si dhe sipas VKM nr.703, datë 18.12.1995 dhe udhëzimit nr.1, datë 29.12.1995 të Ministrisë Bujqësisë dhe Ushqimit. {Kategoria e tokës sipas fshatrave është dhënë në Tabelën A}

1.2.5-Përfshihen nga pagimi i taksës.

Sipërfaqja e tokës bujqësore që mbillet me pemë frutore dhe vreshtari, për një periudhë 5 vjeçare.

1.2.6-Baza ligjore. Ligji nr.9632,dt.30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore“ i ndryshuar, Neni 23, Aneksi 2.

1.2.7- Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës është Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Skrapar si dhe inspektorët taksave pranë Njësive Administrative,dhe Sektori i Kadastrës.

1.3-TAKSA MBI TRUALLIN

1.3.1 Baza e taksës. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit , në m², në pronësi ose përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentave të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një deklaram në bashki ose njësinë administrative ku ndodhet trualli.

1.3.2- Llogaritja e taksës.Detyrimi për taksën e truallit llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme (sipërfaqja e truallit në m²)

1.3.3 Niveli i taksës. Niveli i taksës caktohet në lekë për m² (Tabela Nr.4)

Tabela Nr.4-Niveli i taksës mbi truallin

Emërtimi	Vlera e taksës Lekë/m ² /vit
Taksë Trualli për qëllim banimi nga individë	0.28
Taksë Trualli për qëllim biznesi	15

1.3.4-Taksa e truallit për familjet me banim në fshat.

➤ **Për pjesën e truallit të zënë nga ndërtesa shtëpi banimi, deri në paraqitjen e dokumentacionit të pronësisë (certifikatën e pronësisë) nga Zyra e Rrëgjistrimit të pasurive të paluajtshme, të ndërtesës (shtëpi banimi), vlera vjetore e taksës mbi truallin për familjet me banim në fshat, llogaritet e paguhet me një kuotë fikse 150 lekë/vit**

1.3.5-Baza ligjore.Ligji 9632, dt. 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore“, i ndryshuar, Neni 23/1, Aneksi 2/1.



1.3.6- Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës është Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Skrapar si dhe inspektorët e taksave pranë Njësive Administrative, dhe Sektori i Urbanistikës.

1.4-TAKSA E FJETJES NË HOTEL.

Me “ Hotel “ kuptohet çdo veprimtari që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet, hotel, motel, stabiliment turistik, turizëm familjar e çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.

1.4.1-Detyrimi për pagesën e taksës. Detyrimi për pagesën e taksës i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hotelieri për llogari të bashkisë. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.

1.4.2- Llogaritja e detyrimit. Llogaritja e taksës llogaritet si shumëzim i numrit të netëve të qëndrimit në hotel me nivelin e taksës , lekë për çdo natë fjetje.

1.4.3-Derdhja e të ardhurave. Derdhja e të ardhurave nga taksa e fjetjes në hotel bëhet nga hotelieri në llogarinë e bashkisë.

1.4.4-Afati i arkëtimit. Arkëtimi i të ardhurave nga kjo taksë bëhet **brënda datës 5 të muajit pasardhës.**

1.4.5- Niveli i taksës së fjetjes në hotel. Niveli i taksës së fjetjes në hotel sipas Tabelës Nr.5

Tabela Nr.5-Niveli i taksës fjetjes në Hotel

Emërtimi	Niveli i taksës Lek/netë/fjetje/person
Hotel, motel e çdo njësi tjetër akomoduese sipas ligjit.	35

1.4.6-Baza ligjore. Ligji nr. 9632, dt. 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore “, i ndryshuar, Neni 26, Aneksi 8.

1.4.7- Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës të fjetjes në hotel. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës është Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Skrapar si dhe inspektorët e taksave pranë Njësive Administrative.

**1.5-TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË**

1.5.1- Baza e Taksës. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

1.5.2-Niveli i taksës. Niveli kësaj takse përcaktohet sipas Tabelës Nr.6

1.5.3-Detyrimi i pagesës të taksës. Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit.

1.5.4-Ndarja e të ardhurave kur investimi është në dy bashki. Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.

1.5.5- Përfshihen nga pagimi i kësaj takse. Përfshihen nga pagesa e kësaj takse investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese “Hotel/Resort me pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”.

Tabela Nr.6-Niveli i taksës mbi ndikimin në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

Nr	Emërtimi	Njësia Çorovodë	
		Njësia Çorovodë	Njësitet e tjera
I-	Ndërtime për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njësive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.	4 për qind { të çmimit të shitjes për metër katror.}	4 për qind { të çmimit të shitjes për metër katror.}
II-	Ndërtime të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën a.{ Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e	3 për qind e vlerës së investimit	2 për qind e vlerës së investimit



	turizmit, të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike.}		
III	Për ndërtime që destinohen për tregëti ,shërbime ose banim dhe shërbime në të njëjtën ndërtesë, si dhe ndërtimeve për qëllime publike.	4 për qind e vlerës së nvestimit	2 për qind e vlerës së investimit
IV	Ndërtime për objekte të kultit fetar	2 për qind e vlerës së nvestimit	2 për qind e vlerës së nvestimit
V	Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroportëve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte	0,1 për qind e vlerës së nvestimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.	0,1 për qind e vlerës së nvestimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.
VI	Ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi	0,5 për qind e vlerës së nvestimit.	0,5 për qind e vlerës së nvestimit.

1.5.6-Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesat. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të bashkisë, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi. Në bashki struktura përgjegjëse është Drejtoria e Planifikimit të Teritorit dhe Sektori Tatim Taksave

1.5.7- Baza ligjore. Ligji nr.9632, dt.30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore “, i ndryshuar,

1.6-TAKSA E TABELËS

Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet fizikë dhe juridikë që zhvillojnë veprimtarinë në territorin e bashkisë Skrapar që vendosin tabela për qëllim identifikimi apo reklamimi të veprimtarisë

1.6.1-Tabelë për qëllim identifikimi. Tabelë për qëllim identifikimi, është çdo tabelë e trupëzuar ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri/ mbiemëri ose aktiviteti i biznesit.) *Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulanteve.* Për subjektet tatimpagues



që vendosin më shumë se një tabelë identifikuese, vetëm njëra nga tabelat identifikuese do të konsiderohet si e tillë , kurse tabelat e tjera do të konsiderohen si reklamë.

1.6.2- Tabela për qëllim reklamimi. Në kategorinë reklamë kuptojmë çdo publicitet, formë promovimi që shërben për të njoftuar , tërhequr vëmendjen ose joshur blerësit, të vendosur në pamje jo ballore , në taraca, ballkone, në pjesë të rrugës, shtylla etj që kanë përmbajtje me qëllime reklamimi për vete ose të tretë.

- Çdo tabelë reklamimi që kalon sipërfaqen 35 m², do të konsiderohet sikur është 35 m² dhe shuma e taksës do të llogaritet dhe paguhet vetëm për këtë sipërfaqe pavarësisht nga madhësia e saj në m².

1.6.3-Tabela për qëllim orientimi. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.

1.6.4-Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme. Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë , spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.

1.6.5-Për të gjitha tabelat. Për të gjitha tabelat (me qëllim identifikimi, reklamimi apo orientuese) subjekti duhet të pajiset me leje nga sektori I Planifikimit dhe zhvillimit të teritorit , ku përcaktohen vendi I vendosjes, lloji I tabelës përmasat etj. Një kopje e lejës I dorëzohet Sektorit të ardhurave, I cili llogaritet dhe ndjek arkëtimin e taksës nga momenti I lëshimit të saj.

1.6.6 Baza e taksës. Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja në 21eter katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj.

1.6.7 Niveli I taksës .Niveli I taksës është sipas Tabelës Nr.7.

Tabela Nr.7-Taksa e tabelës sipas llojit dhe sipërfaqes së Tabelës.

Nr	LLOJET E TABELËS	NJ/m	Sasia
I.	Taksë table për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brënda teritorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve(ku shënohet emri/ mbiemri ose aktiviteti I biznesit.		
A	Deri në 2 m ²	lekë/ m ² /vit	0
b	-mbi 2 m ² deri në 10 m ²		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/ m ² /vit	700
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/ m ² /vit	11 500
	-elektronike	lekë/ m ² /vit	15 000
c	Mbi 10 m ² deri 20 m ²		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/ m ² /vit	5 950
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/ m ² /vit	9 775
	-elektronike	lekë/ m ² /vit	12 750



ç	Mbi 20 m ² deri 40 m ²		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/ m ² /vit	3 850
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/ m ² /vit	6 625
	-elektronike	lekë/ m ² /vit	8 250
d	Mbi 40 m ²		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/ m ² /vit	2 800
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/ m ² /vit	4 600
	-elektronike	lekë/ m ² /vit	6 000
II	Tabela për qëllime identifikimi jashtë teritorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim.		
	Tabela identifikuese	lekë/ m ² /vit	120
III	Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme, e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m ²		
	-e thjeshtë (me/ pa ndriçim)	lekë/ m ² /vit	13 500
	-elektronike	lekë/ m ² /vit	27 000
IV	Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire , spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.		
	-të të gjitha llojeve dhe përmasave	Lekë/ m ² / ditë	1 000

1.6.8-Llogaritja e taksës së Tabelës.

